

L I G J
Nr.8531, datë 23.9.1999

PËR SHËRBIMIN E KONTROLLIT TË PLEHËRAVE KIMIKE

(Ndryshuar me ligjin nr. 10 137, datë 11.5.2009)

(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi i këtij ligji është të mundësojë kontrollin e plehërave kimike, të importit dhe të vendit, që qarkullojnë në tregun shqiptar, për të siguruar përdorimin e plehërave të sigurtë e cilësore, në përputhje me kërkesat për ruajtjen e shëndetit të njerëzve, të kafshëve, të bimëve, për mbrojtjen e mjedisit dhe për mbrojtjen e interesave të konsumatorit.

Neni 2

Për efekt të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

"Shërbimi i kontrollit të plehërave kimike" është organizmi i ngritur për zbatimin e këtij ligji dhe të akteve nënligjore.

"Pleh" është lënda organike ose inorganike, që përmban një ose më shumë elemente ushqyese bimë të njohura, të cilat nevojiten për rritjen dhe zhvillimin e bimëve.

"Lënda aktive" kuptohet sasia e elementit apo elementeve ushqyese, në një njësi plehu e shprehur në përqindje.

"Administratori i shërbimit të kontrollit të plehërave kimike" është personi i ngarkuar për drejtimin e shërbimit të kontrollit të plehërave kimike.

"Analizist" është personi zyrtar, që kryen analizat e plehërave kimike, në përputhje me metodat standarde të kryerjes së këtyre analizave.

"Inspektor" është personi zyrtar që kontrollon zbatimin e kërkesave të këtij ligji.

"Mostër" është një sasi plehu që përbën një njësi dhe që ka karakteristika, që mendohen të jenë uniforme.

"Etiketë" është reklama, pamja ose modeli i shkruar, i shtypur ose i vënë mbi ambalazhin e plehërave kimike ose i bashkëlidhur me të, ku përshkruhen karakteristikat kryesore të plehut kimik.

"Tjetërsim" kuptohet çdo ndryshim në treguesit e plehërave kimike, nga ai i deklaruar në etiketë ose në certifikatën shoqëruese.

"Çorientues" kuptohet mosvënia e treguesve të plehërave kimike në etiketë, sipas kritereve të përcaktuara në këtë ligj dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij.

Neni 3

Kriteret dhe rregullat e vlerësimit të plehërave kimike përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU II IMPORTI, TREGTIMI DHE PRODHIMI I PLEHËRAVE KIMIKE (Ndryshuar me ligjin nr. 10 137, datë 11.5.2009)

Neni 4

1. Veprimtaritë e prodhimit, tregtimit, importit të plehrave kimike me rrezikshmëri, të lejuara sipas këtij ligji, përfshihen në kategorinë II.5, të shtojcës së ligjit për licencat. Licencimi i këtyre veprimtarive bëhet sipas ligjit për licencat.

2. Çdo subjekt, që tregon, importon apo prodhon plehra kimike duhet të veprojë në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij.

KREU III ORGANIZIMI I SHËRBIMIT TË KONTROLLIT TË PLEHËRAVE KIMIKE

Neni 5 **Organizimi**

1. Shërbimi i kontrollit të plehërave kimike është në varësi të Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit. Ai organizohet dhe drejtohet nga Instituti i Studimit të Tokave.

2. Shërbimi i kontrollit të plehërave kimike organizon këtë shërbim dhe kontrollon zbatimin e këtij ligji.

3. Administratori i shërbimit të kontrollit të plehërave kimike është përgjegjës për organizimin e punës, në zbatim të këtij ligji dhe të akteve të tjera nënligjore.

4. Analizat zyrtare për shërbimin e kontrollit të plehërave kimike do të kryhen nga Instituti i Studimit të Tokave, pas akreditimit të tij në përputhje me ligjin nr.8464, datë 11.3.1999 "Për standardizimin".

Neni 6

Administratori dhe inspektorët për administrimin dhe zbatimin e këtij ligji propozohen nga Drejtori i Institutit të Studimit të Tokave.

Neni 7

Numri i punonjësve të shërbimit të kontrollit të plehërave kimike dhe paga e tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 8

Detyrat dhe të drejtat e administratorit dhe të inspektorëve përcaktohen në rregulloren e miratuar nga Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit.

Neni 9

Shërbimi i kontrollit të plehërave kimike kryen kontrolle për vlerësimin e cilësisë së plehërave kimike, përpara hedhjes së tyre në treg, si dhe gjatë tregtimit të tyre, për të garantuar sigurinë e jetës, të shëndetit dhe mosndotjen e mjedisit.

Neni 10

Marrja e mostrave dhe analizat e plehërave kimike bëhen në përputhje me standardet përkatëse në fuqi.

Neni 11

1. Kanë të drejtë të marrin mostra për analizë të plehërave kimike vetëm inspektorët, të cilët duhet të jenë të pajisur me autorizimin përkatës.
2. Gjithmonë një pjesë e mostrës, pas bërjes së analizave, ambalazhohet, vuloset dhe i rikthehet personit fizik a juridik, që ka ose shet plehëra kimike.

Neni 12

Kushtet për magazinimin dhe ruajtjen e plehërave kimike përcaktohen nga shërbimi i kontrollit të plehërave kimike.

Neni 13

Detyrimet e subjekteve që prodhojnë apo tregtojnë plehëra kimike

1. Çdo person fizik a juridik që prodhon apo tregon plehëra kimike, duhet t'i japë inspektorit ndihmën e nevojshme, si dhe çdo informacion që i nevojitet për të kryer detyrat dhe funksionet e tij, në zbatim të këtij ligji.
2. Asnjë person nuk mund të refuzojë ose pengojë një inspektor për të kryer detyrat ose funksionet, në zbatim të këtij ligji.
3. Personi fizik a juridik që tregon plehëra kimike, si dhe prodhuesit e plehërave kimike në vend, duhet t'i pajisin ato me treguesit cilësorë siç janë: Përmbajtja e lëndës aktive, e lëndëve që përbëjnë rrezik për sigurinë, shëndetin e njerëzve, të kafshëve, të bimëve dhe për ndotjen e mjedisit. Treguesit e këtyrë analizave duhen deklaruar në etiketë ose në certifikatën përkatëse dhe duhet të shoqërojnë plehërat gjatë tregtimit.
4. Çdo person fizik a juridik që prodhon dhe ofron për tregtim ose tregon plehëra kimike, duhet të shoqërojë çdo sasi plehu kimik me një raport të analizave për treguesit e rrezikshmërisë ose me dokumente që i vërtetojnë këto analiza.
5. Çdo person fizik a juridik që prodhon dhe tregon plehërat kimike, duhet të zbatojë rregullat për ruajtjen dhe magazinimin e plehërave kimike.

Neni 14
Ndalimi dhe blokimi i shitjes së plehërave kimike

1. Ndalohet shitja e çdo lloj plehu kimik që përmban elemente ose përbërës, të cilët dëmtojnë shëndetin e njerëzve, të kafshëve e bimëve, që ndotin mjedisin dhe që nuk kalojnë testin e rrezikshmërisë ndaj shpërthimit.

2. Procedurat dhe rregullat për asgjësimin e plehërave kimike, të ndaluara për tregtim, përcaktohen me udhëzimin e Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit dhe të Agjencisë Kombëtar të Mjedisit.

3. Shitja e plehut kimik, i cili vërtetohet se është i tjetërsuar, blokohet.

4. Inspektori duhet të nxjerrë me shkrim urdhrin për "ndalim shitjeje", "pleh i bllokuar për shitje", "heqje nga vendi" ndaj personi që ka nën kontroll ose ofron për shitje çdo sasi plehu, i cili nuk plotëson kërkesat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij. Urdhri duhet të shoqërohet me procesverbal dhe në çdo sasi ose kontenier vendoset shënimi me përmbajtjen e urdhrit.

5. Zhblokimi për shitje i plehut kimik vendoset nga një komision i përbërë nga administratori dhe dy inspektorë, brenda 5 ditëve pas deklarimit të personit të interesuar, se i ka plotësuar të gjitha kërkesat për shkak të të cilave u bë ky bllokim.

Neni 15
Tjetërsimi i markës

Një pleh trajtohet si markë e tjetërsuar në rast se:

1. nuk është i etiketuar siç përshkruhet në certifikatën ose në dokumentin shoqërues;
2. identifikimi i tij është i falsifikuar ose çorientues në çfarëdo mënyre.

KREU IV
KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE

Neni 16

Shkelja e dispozitave që parashikohen në nenin 13 paragrafët 1 dhe 2 të nenit 14 dhe në nenin 15 të këtij ligji, kur nuk përbën vepër penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 5 000 (pesë mijë) deri në 20 000 (njëzet mijë) lekë nga inspektorët e shërbimit të kontrollit të plehërave kimike.

Neni 17

Kundër vendimit të dënimit mund të bëhet ankimi brenda 10 ditëve nga data e njoftimit të vendimit tek administratori i shërbimit të kontrollit të plehërave kimike, i cili shqyrton ankesën dhe jep vendimin brenda 5 ditëve.

Neni 18

Procedurat e ankimit dhe të ekzekutimit të vendimit bëhen në përputhje me ligjin

nr.7697, datë 7.4.1993 "Për kundërvajtjet administrative", me ndryshimet dhe plotësimet e mëvonshme.

Neni 19

Organet e ruajtjes së rendit, me kërkesën e shërbimit të kontrollit të plehërave kimike, e ndihmojnë këtë shërbim në ushtrimin e funksioneve të caktuara në këtë ligj dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij.

KREU V DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 20

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet e nevojshme nënligjore për zbatimin e neneve 3, 7, 10, 19 të këtij ligji.

Neni 21

Çdo dispozitë, që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohet.

Neni 22

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2455, datë 5.10.1999 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani